



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni Pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 40
Prishtinë, më 13. 09. 2010, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Sabri Hamiti, Xhavit Haliti, Ramë Buja, Nexhat Daci, Alush Gashi, Ardian Gjini dhe Slllobodan Petroviq.

Nga pjesëmarrësit e tjerë: Lumni Murati – ZPRK dhe Besnik Ramadani - KDI.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Sabri Hamiti - kryetar i Komisionit.

R E N D I I D I T Ë S

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 12 korrik 2010;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-132 për Protokollin e shtetit të Republikës së Kosovës;
4. Informim për takimin e komisioneve të Jashtme të Parlamenteve të Evropës Juglindore;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 12 korrik 2010;

Procesverbali i mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 12 korrik 2010, u miratua njëzëri.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-132 për Protokollin e shtetit të Republikës së Kosovës;

Sabri Hamiti - Në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Protokollin e shtetit të Republikës së Kosovës, tha se janë propozuar dispozita plotësuese rreth ceremonialit diplomatik, si dhe ndryshimin i dispozitave: te paraqitja e kredencialeve presidentit të Republikës, te hapja e një përfaqësie të re diplomatike, Presidenti i Republikës, Zonja e Parë, pritjet në Presidencë, te përdorimi i sallës për persona të rëndësishë së veçantë të aeroportit, te radha e përparësisë së rangjeve zyrtare dhe te përparësia e organeve të pushtetit lokal.

Propozoi që për shqyrtimin e këtij Projektligji të formohet grupi punues, i cili do ta shqyrtojë Projektligjin në hollësi dhe propozimamendamentet eventuale, t'ia propozojë Komisionit për shqyrtim në mbledhjen e radhës.

Xhavit Haliti - Mendon se shqyrtimi i këtij Projektligji duhet bërë konform rregullave të rajonit. Projektligji përmban elemente të panevojshme siç është çështja e trajtimit të shefit të agjencisë dhe lë përshtypjen se është i sponsoruar nga pozicioni i individit, e jo nga ai institucional.

Nexhat Daci - Përkrah procedurën për shqyrtimin e Projektligjit, por mendon se është koha që të mos eksperimentohet me shtetin dhe rregullimin e funksionimit protokollar të tij. Shpreson se grupi punues do ta shqyrtojë Projektligjin dhe të propozojë amendamente mbipartiake.

Komisioni pas diskutimit lidhur me formimin e grupit punues, për shqyrtimin e Projektligjit nxori këtë

P ë r f u n d i m

Formohet grupi punues për shqyrtimin dhe amendamentimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Protokollin e shtetit të Republikës së Kosovës, në përbërje: z. Ibrahim Gashi, z. Alush Gashi dhe z. Ramë Buja.

4. Informim për takimin e komisioneve të Jashtme të Parlamenteve të Evropës Juglindore

Sabri Hamiti – I njoftoi anëtarët e Komisionit se takimi i komisioneve të Jashtme të Parlamenteve të Evropës Juglindore do të mbahet më 20 shtator në Prishtinë. Pjesëmarrja në takim është konfirmuar nga përfaqësues të Shqipërisë, Bullgarisë, Maqedonisë, Malit të Zi, Turqisë, Kroacisë, Sllovenisë dhe pritjet të konfirmohet edhe nga përfaqësuesi i Parlamentit Evropian. Hapjen e takimit do ta bëjë Kryetari i Kuvendit. Çdo përfaqësues i komisionit të ftuar do të ketë paraqitjen e vet sipas radhës së alfabetit. Po ashtu është planifikuar që të propozohet një draftdeklaratë nga takimi, nxjerrja e së cilës varet nga vullneti i pjesëmarrësve. Gjatë mbajtjes së takimit pjesëmarrja e anëtarëve të Komisionit tonë do të jetë e plotë. Për nevoja të përkthimit në tri gjuhë propozoi që takimi të mbahet në sallën C-301 të ndërtesës së Kuvendit.

Kërkoj mendimin e anëtarëve të Komisionit para përfundimit të agjendës përfundimtare lidhur me nevojën që të ftohet edhe ndonjë përfaqësues nga Parlamenti Evropian. Propozoi që në këtë takim të ftohet edhe kryetari i Komisionit për Integritet Evropian.

Nexhat Daci - Propozoi që në këtë takim të ftohet edhe ministri ynë i jashtëm, si dhe të tentohet edhe një herë të ftohet përmes kanaleve diplomatike, Komisioni i Jashtëm i Serbisë.

Xhavit Haliti mendon se në këtë takim do të duhej të ftoheshin edhe ambasadorët e huaj që janë në Kosovë, edhe pse ata varësisht nga protokolli i tyre, mund të vinë në shoqërim të përfaqësuesve të tyre.

Drafti i Deklaratës do të ishte mirë të jetë i përgatitur dhe të diskutohet bashkërisht para se të prezantohet në takim. Mbajtja e takimit në ndërtesën e Kuvendit, nuk lejon hapësirë të mjaftueshme për prezencën e mediave. Është i rëndësishëm angazhimi nga ana teknike e pritjes së përfaqësuesve, që nga hyrja në kufi e deri te vendosja në hotel.

Lidhur me vendin e mbajtjes së takimit, pjesëmarrjen e mediave gjatë takimit, shoqërimin e delegacioneve, diskutuan deputetët: N. Daci, A. Gjini, R. Buja, Xh. Haliti dhe Sabri Hamiti.

Sabri Hamiti - Tha se nuk ka sallë më të përshtatshme për këtë destinim se sa salla C-301 e Kuvendit, ku mund të përmbushen nevojat e përkthimit për pjesëmarrësit, e po ashtu edhe të vendoseshin disi mediat. Ministri i Jashtëm do të ftohet nëse nuk do të gjendet jashtë vendit. Përfaqësuesit e zyrave të huaja në Kosovë, nuk është e nevojshme të ftohen zyrtarisht.

Xhavit Haliti - Propozoi që më 21 shtator, në përcjellje të Komisionit të organizohet për pjesëmarrësit e takimit një vizitë në Muzeun Etnologjik dhe pastaj të vizitohet qyteti i Prizrenit.

Mbledhja përfundoi në orën 11: 00.

Kryetari i Komisionit

Sabri Hamiti

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit